

FJALA E DEPUTETIT SALI BERISHA

E ENJTE 10 SHKURT 2022

Të nderuar qytetarë dhe qytetare,

Zotërinj deputetë,

Këtu po diskutohet për një rën nga pseudoreformat me pasoja më katastrofale në historinë e këtij vendi, të ashtuquajturën “reformë të drejtësisë”, që i preu, i këputi shtyllën kurrizore shtetit shqiptar. Kjo reformë pati pasoja nga më katastrofalet për qytetarët shqiptarë, për shtetin shqiptar dhe për Shqipërinë. Kam folur shumë herë, por në themel të këtyre pasojave qëndron manipulimi dhe përdorimi i procesit të vetingut si hanxhar politik për gjahun e shtrigave, për spastrimin e drejtësisë mbi baza krahinore, fetare dhe politike. Në këtë sallë, por edhe jashtë saj, e kam paralajmëruar me dhjetëra herë Edi Ramën për këtë katastrofë që do të vijë, por ai është përpjekur të lajë duart për çdo gjë, duke fajësuar të huajt. Jam përballur edhe me faktorët ndërkombëtarë, sepse kam mbrojtur interesin e qytetarëve, por në mënyrë absolute përgjegjësia totale për këtë reformë është e Edi Ramës dhe e grupit që e mbështeti atë, sepse nuk mund të lejojë kurrë dhe të pranojë, por e përzgjodhi me qëllim përdorimin e vetingut me metodën nga lart – poshtë në vend të asaj nga poshtë-lart. Përdorimi i vetingut me metodën lart-poshtë apo top-down është universalisht i njohur si metodë destruktive/shkatërrimtare.

Një kryeministër, i cili pranon që vendi i tij të mbetet pa Gjykatë Kushtetuese dhe Gjykatë të Lartë, një kryeministër, i cili pranon që vendi të mbetet pa shtet ligjor, ai nuk është kryeministër. Nuk ka shtet ligjor pa Gjykatë të Lartë dhe Gjykatë Kushtetuese. Ai në çdo variant është një përbindësh i ethshëm për pushtet dhe që do të akaparojë të gjitha pushtetet, të arrijë këtu ku ka arritur sot me 10% pushtet më shumë se diktatori i fundit komunist në Europë. Cilat janë pasojat e kësaj reforme? Me dhjetëra e dhjetëra gjykatës/e të rinj u përzunë nga drejtësia. Po ju rikujtoj këtu se çfarë thotë Komisioni i Venecies në raportin e tij: “Nuk ishte objekt shqyrtimi vetingut”. Komisioni konstatoi se afatet trejavore të paraqitjes së dokumenteve ishin përdorur si hanxhar për të larguar njerëzit që nuk sillnin dot dokumente për shkak se duhet t’i merrni nga jashtë e të tjera, ndërsa të tjerëve, në kundërshtim me ligjin dhe pa asnjë bazë ligjore, u viheshin në dispozicion muaj të tërë. U përzu nga drejtësia gjykatësi Fatmir Hoxha, i cili kishte harruar të deklaronte në vitin 2003 një depozitë të bashkëshortes, dhe e kishte deklaruar në vitin 2004. U largua nga drejtësia gjykatësi Besim Trezhnjeva, i cili nuk kishte deklaruar konton bankare të vajzës së tij, Etoa, nga rroga. U mbajt famëziju Dvoran, që fshehu 82 mijë euro bashkë me familjen e tij, u mbajt famëziju Dvoran, të cilit Albtelecomi, në konflikt absolut interesi, i pagoi 17 mijë euro apartamentin. U mbajt famëziju Dvoran, apartamenti i të cilit ishte deklaruar edhe sa metra ishte, por na doli 127 metra. U mbajt njeriu, i cili u gjet se shkeli Kushtetutën në Komisionin e Venecies. U mbajt Sokol Sadushi, i cili kishte blerë apartament në vitin 2006 nga një person, që nuk dihet se ku i kishte gjetur paratë e blerjes dhe këtë apartament, ndonëse e linte të regjistruar mbi të, në vitin 2012 e kishte vendosur në kolateral bankar.

U mbajt Sokol Sadushi, që deklaronte dhuratën prej 20 mijë eurosh të gjyshes për fëmijët, kurse, gjyqtare një tjetër, kur deklaronte se këto para i kishte dhuratë nga babai i saj dhe i ka dhënë çdo muaj nga rroga, nuk besohej se ishte e djathtë. U mbajt një gjykatës tjetër, vila e të cilit qëllon e ndërtohet nga kunati trafikant i drogës. U përzu një tjetër se nuk kishte deklaruar një garsonierë të vitit 1994.

Këto ishin disa nga aspektet e këtij akti të shëmtuar, që u përdorën si hanxhar për politikën. Po cilat janë pasojat katastrofale të vetingut sot? Shqipëria dhe qytetarët shqiptarë kanë humbur të drejtën e të pasurit një proces gjyqësor të ndershëm. Asnjë prej jush nuk keni humbur asgjë, se ju i rregulloni si të doni proceset, por pyesni atë që pret 5 vjet, 10 vjet apo 15 vjet dhe shkon në botën tjetër pa e mbaruar dot procesin gjyqësor. Çfarë ndodhi tjetër? Shqipëria u bllokua për 3 vjet për integrimin, një “jo” për shkak të mungesës së gjykatave. Shqipëria u shndërrua në head coard-in kryesor të trafikeve, të drogave të të gjitha vendeve të Europës. Çfarë ndodhi tjetër? Nga burgjet dalin kriminelë, se nuk ka njerëz që t’u hapin dosjet. Unë e kam të lehtë të them se ky apo ai deputet ndërhyr për lirim të tij, por unë e di edhe tjetrën, dhe nuk mund ta mohoj, se nuk ka prokurorë për të hapur mijëra dosje në prokurori dhe nuk ka kush t’i hapë më. Tani ju kërkoni këtë anije të mbytur, për të cilën shqiptarët janë shprehur. Vetëm 7% e qytetarëve, që nuk marrin pjesë në votime, e quajnë të vlefshme reformën, të gjithë të tjerët janë kundër. Vetëm 24% e shqiptarëve flasin. Po çfarë bëtë më tej ju?